

## STATUT

Në këtë statut;

“Ligji” është ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

- “Statut” është Statuti i Shoqërisë,
- “Shoqëria” është Shoqëria “Erdu Capital” sh.p.k.

### KREU I

**Themelimi,Emri,Objekti,Kohëzgjatja,Selia**

**Neni 1:**

**Data e themelimit,Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot,më datë 06.12.2021,Unë,themeluesi,kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Erdu capital” sh.p.k,që ketej e tutje do të quhet Shoqëria.

(2) Themelues i Shoqërisë është Z.Ermal Duro i biri i Yllit dhe i Zymbyles,lindur në datë 02.02.1988 në qytetin Permet,banues rruga “Hamdi Pepa” ish konvikt i ndertimit,nd.35, (ndërtesë private )Njesia Nr.6 Tirane,me nr.personal I80202062V.

**Neni 2**

**Objekti i Veprimtarisë**

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë aktivitet e mëposhtme:

- Konsulence;
- Tele-marketing;
- Formim profesional dhe Trajnim personeli;
- Shitje produktesh në web;

-Sherbim marketing në web.

Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj,që ka lidhje me po këtë objekt apo e mbeshtetë atë.

Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi që kanë lidhje me fushën e veprimtarisë.

Gjithashtu shoqëria zbaton standartet më të larta të etikës.

### **Neni 3**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qëndren Kombëtare të Biznesit.

### **Neni 4**

#### **Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresen: Rruga “Sami Frashëri”,Zona kadastrale 8270,Nd.34,H.5,Njësia administrative nr.5 Tiranë.

Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë tjeter,brenda këtij qyteti apo në një qytet tjeter të vendit.

Shoqëria mund të hapë degë ,zyra përfaqësimi dhe qëndra të zhvillimit të aktivitetit kudo brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Selia e shoqërisë dhe qëndra e zhvillimit të aktivitetit mund të ndryshohet me vendim të administratorit.

#### **KREU II**

#### **Kapitali**

### **Neni 5**

#### **Kapitali Themeltar**

## **Kapitali Themeltar**

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10.000 (dhjetëmijë) lekë i ndarë në një kuotë me vlerë 10.000 lekë. Pjesmarja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhej me kontributin e tij:
- (2) Ortaku themelues Ermal Duro është zotru i në kuote me vlerë të përgjithshme 10.000 lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtëshme, të paluajtëshme apo të drejta).

### **Neni 6:**

#### **Zmadhimi dhe zvoglimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesvë të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi prekë ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesve të kapitalit që përfaqësojnë.

### **Neni 7:**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet;

- a) kontributin në kapitalin e shoqërisë,
- b) shitblerjes,
- c) trashëgimisë,

ç) dhurimit,

d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

#### **Organet Vendimmarrese dhe Drejtuese**

##### **Neni 8:**

##### **Organet Vendimmarrëse**

Në shoqërinë “Erdu Capital” sh.p.k, për sa kohë kuota zotërohet nga një ortak i vetëm, të gjithë të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i vetem në përputhje me nenin 81 pika 3 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërítë Tregtare”. Asambleja e Ortakëve (Ortaku i Vetëm) është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modelevit të përcaktuar në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë,
- b) ndryshimin e statutit,
- c) emrimin dhe shkarkimin e administratorve,
- c) emrimin dhe shkarkimin e e likujdusve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar,
- d) përcaktimin e shpërblimeve për pësonat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike,
- dh) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë

pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,

- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- ë) zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit,
- f) pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre,
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorve,
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,
- h) miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë,
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjeter apo nga një përsone i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshinë edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rënd dite.

## Neni 9

### Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Pergjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë, ose nëse parashikohet nga statuti me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpresa datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për të marrë vendime, pavarësisht parregullesisë së njoftimeve.

## Neni 10

### KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve,që kërkojnë një shumicë të zakonshme,asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote,që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje,të cilat kërkojnë shumnicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit nr.9901,datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”,ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm,nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave,janë të pranishëm personalisht,votojnë me shkresë,apo me mjete elektronike,sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur më lart ,asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë,me të njëtin rënd dite.

## Neni 11

### Marrja e vendimeve

Asambleja e Përgjithshme vendosë me tre të katërtat e votave të zotëruarve të kapitalit,të ortakëve pjesmarrës,për ndryshimin e statutit,zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar,shpërndarjen e fitimeve,riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendosë me shumicën e votave të ortakëve pjesmarrës,për çështje të tjera si;

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë,
- b) emrimin dhe shkarkimin e administratorve,
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar,
- ç) përcaktimin e shpërblimeve,
- d) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët,përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së

- veprimtarisë,
- e)përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorve,
- f) miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë. Çdo ndryshim statute duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## Neni 12

### **Përjashtimi nga e drejta e votës**

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij,
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij,
- c) ngritjen e një padie nga shoqëria,
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar,i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interesit,ashtu si dhe ortaku,të cilin përfaqëson.

## Neni 13

### **Administrimi**

1.Shoqëria drejtohet dhe përfaqësohet nga administratori (et).Administratori mund të jetë i çdo kombësie dhe nuk është e domosdoshme të jetë resident në Shqipëri.Asambleja e përgjithshme emron një ose më shumë përsone fizik si administratorë të shoqërisë.Emrimi i administratorve prodhon efekte pas regjistrimit në Qëndren Kombëtare të Biznesit.

2.Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë,sipas përcaktimeve të nenit 207 të këtij ligji,nuk mund të emrohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.Çdo emrim i bërë në kundërshtim me këtë dispozitë është i pavlefshëm.

3. Administratori i shoqërisë do të jetë Ermal Duro i biri i Yllit dhe i Zyhmbyles,lindur në datë 02.02.1988 në qytetin Permet,banues rruga "Hamdi Pepa" ish konvikti i ndertimit,nd.35,(ndertesw private)Njesia Nr.6, Tirane,me nr.personal të ID I80202062V.

Kohëzgjatja e emrimit të administratorit (eve) është për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh,duke filluar që nga momenti kur ajo detyrë merr fuqi ligjore (regjistrimi pranë Qëndren Kombëtare të Biznesit),me të drejtë ripërtitje të këtij afati.

## Neni 14

### **Kompetencat e administratorit (eve)**

Administratori (et) kanë të drejtë e detyrohen:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë,duke zbatuar politikat tregtare,të vendosura nga asambleja e përgjithshme,
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare,
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë,
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor,bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim,
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat,që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë,
- f) kryejnë regjistimet dhe dërgojnë të dhënët e detyrueshme të shoqërisë,sic parashikohet në ligjin për Qëndren Kombëtare të Biznesit,
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare,
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme,në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndermjetme financiare,rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjeter aktivet,të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë,që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- Shoqëria brënda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj,propozon të blejë nga një ortak pasuri,që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë,që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator,ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme .Paditë që lidhen me shpërblimin e administratorit,në bazë të marrëdhënjeve kontraktore me shoqërinë,rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 15**

### **Përgjegjësitë e administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht,ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve,për shkelje të ligjeve,për shkelje të statutit,apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen,për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit,pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë,sipas neneve 14,15,17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”,administrator detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interes më të mirë të shoqërisë në tërsi,duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht,
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëlimeve të përcaktuara në këto dispozita,
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet ,për të cilat merret vendim,

- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit,present apo të mundshëm,të interesave pësonale me ato të shoqërisë,
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori gjatë kryerjes së detyrave të tij përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim,që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare,me përjashtim të rasteve kur,në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse,veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
  3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale,sipas pikave 1 e 2 të këtij neni,është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet,që rrjedhin nga kryerja e shkeljes,si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo pësonat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.  
Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua.Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator,ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
  4. Në mënyrë të veçantë,por pa u kufizuar në to,administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara,nëse në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”,kryejnë veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet,
  - b) u paguan ortakëve interesat apo divedendë,
  - c) u shpérndanë aktive shoqërisë,
  - c) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare kur,në bazë të gjendjes financiare,duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet,
  - d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit,ortakët individualisht ose së bashku,kanë të drejtë të ngenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë,përfshirë dhe dëmshpérblimin financiar,nëse është e nevojshme.Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

**KREU IV**  
**Viti finansiar-ekspertët**

**Neni 16****Viti Financiar**

Viti fanaciар i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor.Përjashtimisht viti i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qëndren Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt me 31 dhjetor.

**Neni 17****Ekspertët**

Nëse kërkohet,Ortaku (et) duhet të caktojnë ekspertin kontabël të autorizuar në numrin dhe kohëzgjatjen e përcaktuar nga legjislacioni shqiptar.Eksperti ka përdetyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë,atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij përrastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakve.


Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatitë raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe për atë përkontrollet periodike të ushtruara,të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrta e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

**KREU V**  
**Prishja -riorganizimi i shoqërisë**

**Neni 18****Prishja dhe likujdimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj,
- me vendim të Asamblesë së Ortakëve,
- me hapjen e procedurave të falimentimit,



- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723,datë 3.05.2007 "Për Qëndren Kombëtare të Regjistrimit (Biznesit)",
- e) me vendim të gjykatës,

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likujdator dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emertesën shtesë, "shoqëri në likujdim e sipër".

Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likujdimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likuduesit e emruar nga ortakët. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emrimin e likuduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes së shoqërisë, çdo përsone i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likudues.

## **Neni 19**

### **Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën e IX të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

## **Neni 20**

### **Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfardo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë që ka lidhje me aktivitetin e shoqërisë.

## **Neni 21**

### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## Neni 22

### **Të ndryshme**

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të, në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ky statut përpilohet në katër kopje dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortaku themelues.

## **ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË ME PËRGJEGJË TË KUFIZUAR**

**Erdu Capital sh.p.k**

**Ermal Duro**

